



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 892/1 prot.

Tiranë më 18.5.2021

Lënda: Mendim për projektvendimin.

**MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj, nr. 3467 Prot., datë 12.05.2021, me anë të së cilës kërkohet mendimi lidhur me projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 12.10.2016 “Për menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit tregtar dhe disa rregullime të mënyrës së funksionimit të regjistrit të anijeve të peshkimit”, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas analizimit të këtij akti dhe relacionit shpjegues përkatës, e vlerëson të hartuar në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”).

Ju bëjmë me dije se, legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale nuk ofron mbrojtje për personat juridikë dhe fizikë tregtarë (të dhënat e të cilëve janë haptazi publike në Regjistrin tregtar publik të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit) por vetëm për individët, si subjekte të të dhënave personale, sipas përkufizimit të parashikuar në pikën 1, të nenit 3 të Ligjit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

